



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.350, datë 25.10.2021

MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË PROKURORIT ALBERT KULIÇI, KANDIDAT PËR POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 159, pika 1 dhe 2 germa "a", 184 dhe 189, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenet 32 dhe 52, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në germën "ç", pika 8, Seksioni Ç, të Kreut VI, të Rregullores "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 171, datë 27.9.2019 e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar, në pikën 5, të nenit 9, të Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm", miratuar me Vendimin nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe pasi u njoh me Relacionin "Mbi verifikimin e pasurisë, figurës të prokurorit Albert Kuliçi, kandidat për pozicionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë", Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të vlerësojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidatit Albert Kuliçi, kandidat për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Lejimin e kandidatit prokuror Albert Kuliçi të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Albert Kuliçi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
SANDËR BECI**

**ANËTAR
VATË STAKAJ**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**